

URDHËR
Nr. 44, datë 24.1.2019

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, nëpërmjet autorizimit të lëshuar.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar me vendimet përkatëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, qendrore dhe territoriale, të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Drejtorinë e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv/Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Arkiv /Protokollit, institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

Nr. prot. Tiranë, më ____/____/2019

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN ADMINISTRATIVE/ CIVILE ME PALË:

Paditës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 467, datë 2.10.2017, “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj. _____, me detyrë _____, për të përfaqësuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin / rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit (në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse).

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Oltjon Muzaka